



Menaxhimi i Projekteve

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Menaxhimi i Projekteve

Përmbajtja

Menaxhimi i Projekteve;

I

- ▶ Hyrje në menaxhimin e projektit.
- ▶ Koncepti I menaxhimit të projektit;
- ▶ Parimet e menaxhimit me projektin;

Projekti

- ▶ Çka është projekti?
- ▶ Karakteristikat e përbashkëta të projekteve;
- ▶ Vetitë e përbashkëta të projekteve, Faktorët dallues të projekteve; Dallimet në mes të projektit publik dhe atij privat;
- ▶ Dallimet ndërmjet projektit dhe operacioneve; Çfarë mund të jenë operacionet?



Menaxhimi i Projekteve;

Hyrje në menaxhimin e projektit, Parimet e menaxhimit me projektin;

Çka është projekti, Karakteristikat e përbashkëta të projekteve, Dallimet në mes të projektit publik dhe atij privat; Dallimet ndërmjet projektit dhe operacioneve;

Hyrje në Menaxhim Projektsh

- Menaxhimi i projektit, është aplikimi i njohurive, shkathtësive dhe teknikave për të ekzekutuar projektet në mënyrë efektive dhe efikase. Është një kompetencë strategjike për organizatat, duke u lejuar atyre që të lidhin rezultatet e projektit për objektivat e biznesit - dhe në këtë mënyrë, më mirë të konkurrojnë në tregjet e tyre.

Njohuritë e Menaxhimit të projektit bazohen në dhjetë fusha:

- Fushëveprimi,
- Integrimi,
- Koha,
- Kosto,
- Cilësia,

- Prokurimi,
- Burimet Njerëzore,
- Komunikimet,
- Menaxhimi i Rrezikut,
- Menaxhimi i grupeve të interesit



Hyrje në Menaxhim Projektesh

- Menaxhimi i projektit synon në thelb në prodhimin e një produkti final që do të ketë ndikim në disa ndryshime për të mirën e organizatës që nxiti realizimin e projektit. Eshtë inicimi, planifikimi dhe kontrolli i një sërë detyrash të nevojshme për të ofruar këtë produkt final, që mund të jetë një produkt fizik, mund të jetë një softuer i ri ose diçka më pak e prekshme si një mënyrë e re për të punuar.



Hyrje në Menaxhim Projektsh

- Pasi që çdo projekt do të përfshijë një lloj të ndryshimit, menaxhimi i ndryshimit është një pjesë integrale e procesit të Menaxhimit të Projektit. Dhe për shkak se ka ndryshim ka të ngjarë të ketë rreziqe kështu që menaxhimi i rrezikut është pjesë integrale e menaxhimit të projektit.



Definicione të Projektit

□ Çfarë është një projekt:

- Projekti është sipërmarrje unike me një afat fillimi dhe përfundimi, që ndërmerret për të përmbushur qëllimet e përcaktuara Brenda parametrave të kostos dhe cilësisë.
- Projekti është një përpjekje e përkohshme që ndërmerret për të krijuar një produkt apo shërbim unik,
- Projekti përfshinë ndërmarrjen e një sërë aktiviteteve të ndërlidhura e të koordinuara, që orientohen drejt arritjes së qëllimit, që kanë një kohëzgjatje të përcaktuar.



Definizione të Projektit

Një set unik i aktiviteteve të koordinuara, me afat të definuar të fillimit dhe mbarimit, të ndërmarra nga një individ ose organizatë për të përmbushur objektivat specifike brenda orarit të përcaktuar, koston dhe parametrave të performancës.



Definicione të Projektit

□ Çfarë është një projekt:

- Është një grup aktivitete të përkohshme projektuar për të prodhuar një produkt unik, shërbim ose rezultat.
- Një projekt është **i përkohshëm** në atë se ka një fillim dhe një fund të përcaktuar në kohë, dhe për këtë arsye fushëveprimin dhe burimet e definuara.
- Dhe një projekt është **unik** në atë që nuk është një operacion rutinë, por një grup i veçantë i operacioneve të dizajnuara për të përmbushur një qëllim. Pra një ekip projekti shpesh përfshin njerëz të cilët zakonisht nuk punojnë së bashku - nganjëherë nga organizata të ndryshme dhe nga vende të ndryshme.

Karakteristikat e përbashkëta të projekteve

Karakteristika të projekteve

- 1) Projektet janë përpjekje e përkohshme me cikël jetese të definuara
- 2) Janë elemente për ekzekutimin e strategjive të ndërmarrjes/organizatës
- 3) Mundësojnë futjen e produkteve/shërbimeve të reja dhe përmirësimin e produkteve ekzistuese në ndërmarrje.
- 4) Japin filozofinë dhe strategjinë për menaxhimin e ndryshimit



Karakteristikat e përbashkëta të projekteve vazhdim

Karakteristika të projekteve

- 5) Menaxhimi i projektit kërkon bashkëpunim ndër-funksional në ndërmarrje
- 6) Funkcionet e menaxhimit Planifikim → Organizim → Vendosje Stafi → Udhëheqje → Kontroll zbatohen në menaxhimin e projektit
- 7) Rezultatet e projektit lidhen me përmbushjen e kërkesave të klientit Brenda kushtëzimeve teknike, të kostos dhe afatit.
- 8) Projekti përfundon me ciklin e tyre të jetës ose me arritjen e sukseshme të objektivave.



Dallimet ndërmjet projektit dhe operacioneve

Dallimi mes projekteve dhe aktiviteteve të ndërmarrjes

- ▶ Aktivitetet e ndërmarrjes përsëriten në mënyrë të vazhdueshme.
- ▶ Projektet lidhen me kryerjen e aktiviteteve që kanë një kohëzgjatje të limituar të zbatimit dhe përfundojnë me arritjen e qëllimeve të projektit.

Natyra e operacioneve rutinore në ndërmarrje bën që vëmendja të fokusohet tek “orientimi sipas procesit” kryerjen e aktiviteteve me sa më shumë eficiencë dhe në mënyrë të vazhdueshme

PROCESI = Hapa të përsëritshëm të paraqitur në mënyrë kronologjike

PROJEKTI = Përpjekje e vetme me hapa/aktivitete të shumta.



PROJEKTI



PROCESI

Karakteristikat dalluese në mes projekteve të sektorit publik dhe privat

Procesi	Projekti
Proces apo produkt që përsëritet	Proces apo produkt i ri
Aktivitete që kryhen vazhdimisht për të prodhuar mallra & shërbime	Me një kohëzgjatje të kufizuar
Një mori objektivash	Një objektiv
Specialist sipas fushave funksionale	Përfshirja e specialistëve të shumë fushave funksionale
Sisteme & struktura të mirëpërcaktuara organizimi	Sisteme & struktura të përkohshme sa zgjatë projekti
Siguri më e madhe në lidhje me performancën, Koston dhe Afatin	Pasiguri më e madhe në lidhje me performancën, Koston dhe Afatin
Mbështet status kuon	Mbështet ndryshimin

Trekëndëshi i Projektit



Gjërësisht këto objektiva, të cilat zakonisht janë të definuara si pjesë e rrethanës së biznesit dhe të përcaktuara në projekt, shumica përmbushin tri kritere themelore:

Projekti duhet të përfundoj në kohë

Projekti duhet të realizohet brenda kostos së buxhetuar

Projekti duhet të plotësojnë kërkesat e cilësisë të përcaktuara

Mjedisi rrethues i projektit

16



Aktivite filestare te projektit

Për shembull, në qoftë se një projekt përfshin ndërtimin e një fabrike të re, menaxheri i projektit duhet:

- ▶ të njoh se si do të veprojë fabrika e re.
- ▶ të kuptoj nevojat e shfrytëzuesve të punishten e re.
- ▶ të kuptoj se pse klienti dëshiron fabrikën e re.
- ▶ Një pamje të qartë të asaj që është e përfshirë në ndërtimin e uzinës dhe çfarë pritet prej tij.
- ▶ Për të qenë i sigurt që fabrika e re në të vërtetë do të zgjidhë problemin ose në mënyrë të përshtatshme u adresohet mundësive të paraqitura. Nëse problemi apo mundësia nuk është identifikuar saktë, fabrika, madje edhe nëse e ndërtuar me sukses, do të ishte një dështim.

Një përkufizim i qartë i projektit dhe objektivat e qarta janë kritike për suksesin e projektit. **Nëse përkufizimi dhe objektivat janë të paqarta, jo realiste, apo jo të shkruara, projekti është në vështirësi serioze para se të fillon.** Çfarëdo kohe dhe energjie që ju duhet për të përcaktuar projektin siç duhet në fazën e planifikimit është shumë më pak se çfarë ajo do të kushtojë për të rregulluar problemet pasi të përfundojë projekti.

Karakteristikat dalluese në mes projekteve të sektorit publik dhe privat


Karakteristikat	Sektori Privat	Sektori Publik
Madhësia e investimeve	Mesatare dhe të vogla	Të mëdha
Mesatarja e jetëgjatësisë	2-20 vite	20 – 40 vite
Synimi	Fitimprurës	Jo fitimprurëse, interes publik.
Burimet e financimit	Rezervat, kreditë, pronarët individual	Taksa, tatime, fonde private
Kriteret e përzgjedhjes	Prioritet në normën e kthimit	Kritere të shumfishta
Ambienti vlerësues	Prioriteti ekonomik	Politikisht i prirur

Objektivat e Projektit

- ❑ Tregojnë se cili është sukcesi apo ndikimi specifik i projektit
- ❑ Realizimi i tyre mundëson realizimin e qëllimit
- ❑ Tregojnë se çka saktësisht do të arrihet, sa do të arrihet (sasia), kur do të arrihet (koha) dhe nga cila njësi organizative (përgjegjësia)
- ❑ Tregojnë se deri në ç'masë janë plotësuar nevojat e klientëve

Karakteristikat e objektivave

- Objektivat e Planit duhet të jenë specifike të cilat mund të maten.
- Mundësia e zbatimit të tyre varet nga mundësia e gjurmimit të progresit dhe matjes së rezultateve




... pra
Objektivat
janë **SMART**
(ang.)

Rëndësia e Menaxhimit të Projektit



Duke u përpjekur për të zbatuar një projekt pa menaxhimin të projektit, është sikur të përpiqemi të luajm një lojë futbollli pa një plan të lojës!



Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu